



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Qeveria / Government  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministry of Culture, Youth and Sport

# RAPORT PUNE

(Janar – Prill 2018)

Resul Makreshi  
Zëvendesministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

PRILL 2018

## TABELA E PËRMBLEDHJES

<b>I.</b>	<b>HYRJE.....</b>	<b>3</b>
<b>II.</b>	<b>TAKIME INSTITUCIONALE.....</b>	<b>4</b>
i.	Niveli qendror dhe lokal.....	4
ii.	Organizata Jo qeveritare.....	5
iii.	Klube Rinore dhe Sportive.....	6
<b>III.</b>	<b>VIZITA TË NDRYSHME.....</b>	<b>7</b>
<b>IV.</b>	<b>DEBATE PUBLIKE.....</b>	<b>8</b>
<b>V.</b>	<b>ORGANIZIME.....</b>	<b>9</b>
i.	Aktivitete Kulturore e Sportive.....	9
<b>VI.</b>	<b>MEDIA.....</b>	<b>10</b>
i.	Intervista televizive dhe të shkruara.....	10
<b>VII.</b>	<b>FOTOGRAFI TË AKTIVITETEVE.....</b>	<b>11</b>

## I. HYRJJE

Ky raport pasqyron punën 100 ditore të zëvendesministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit z.Resul Makreshi, brenda periudhës Janar – Prill 2018. Në këtë raport janë përfshirë aktivitetet kryera dhe të ndërmarra nga zëvendësministri z.Makreshi, gjatë kësaj periudhe, të cilat janë paraqitur sipas fushave që mbulon institucioni në fjalë.



Ky raport tenton të paraqesë Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjegjesisht zyrës së Kryeministrit z.Ramush Haradinaj, një pamje të qartë të iniciativave, aktiviteteve dhe punës së përditshme si dhe problemeve e pengesave që ministria e kulturës, rinisë dhe sportit ka hasur gjatë kësaj periudhe. Ky 100 ditësh ka qenë pa dyshim një fazë përplotë me sfida, por edhe me suksese.

Gjatë kësaj periudhe kam qenë i angazhuar në shumë aktivitete kulturore e sportive, takime të ndryshme, intervista, debate publike me qytetarë etj. Çdoherë në bashkëpunim me kabinetin e ministrit z.Kujtim Gashi, jemi angazhuar që të krijojmë mundësi dhe hapsira për vlerat kulturore, aktivitetet sportive dhe rinin Kosovare, si dhe çdo mangësi apo ngecje të deri tanishme ta përmiresojmë, të njejtën kohë ta zhvillojmë dhe ngrisim në vazhdimsi në menyrë që institucioni jonë ta kryej punën ashtu siq duhet.

## **II. TAKIME INSTITUCIONALE**

### **i. Niveli qendrore dhe lokal**

Nga muaji Janar-Prill 2018, kam realizuar një sërë takimesh, ku të gjitha kanë luajtur rol pozitiv në procesin e aktiviteteve dhe zhvillimit në fushën e kulturës, rinisë dhe Sportit, gjë që po na ndihmon shumë në organizimin, bashkëpunimin dhe realizimin e punëve të përditshme që kemi.

Aktiviteti i pare ka filluar me takimin e kryetarit të komunës së Fushë Kosovës z.Burim Berisha. Ky takim kishte për qëllim njoftim lidhur me punën ndaj qytetarëve të kësaj komune, respektivisht komuniteteve Ashkalinjë, Rom dhe Egjiptian. Diskutuam shumë çështje lidhur me mbështetjen dhe përkrahjen e të rinjëve në Fushë Kosovë, në fushën e sportit dhe kulturës. Kemi arritur që të krijojmë një bashkëpunim shumë të mirë me komunën e Fushë Kosovës.

Aktiviteti radhës ka qenë takim me Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, z.Shyqiri Bytyqi, ku diskutuam për fushën e arsimit, kryesisht përkrahjen e studentëve nga komuniteti Ashkalinjë me bursa, ku e dijmë që tani kemi një numër të madh të studentëve tanë, por që nga gjendja ekonomike qëndrojnë dobët. Ministri Bytyqi shprehu përkrahje, dhe i gatshëm t'i ndihmoj komunitetet në çdo proces, në mënyrë që ata ta vazhdojnë shkollimin. Së bashku me z.Bytyqin, jemi dakorduar që ta ndihmojmë çdo proces drejtë edukimit dhe shkollimit të fëmijëve nga radhët e komuniteteve Rom, Ashkalinjë dhe Egjiptian.

Gjatë kësaj kohe, zhvillova edhe një takim tjetër me sekretarin e përgjithshëm të federatës së karates në Kosovë, z.Nazmi Gashi, ku për qëllim kishim përkrahjen e të rinjëve Ashkalinjë, në sportin e karates, ku kemi parasysh që nga të rinjtë Ashkalinjë kemi shumë të talentuar në këtë sport. Z.Gashi, ishte i knaqshëm me të rinjtë tanë në karate, dhe ishte i gatshëm t'i ndihmoj çdoherë, pasi që shumë të rinjë dhe të talentuar janë të regjistruar në federatë, dhe po zhvillojnë shumë gara me sukses në Kosove dhe jashte saj. Për mua është shumë e rëndësishme që të rinjtë e komunitetit Ashkalinjë, të jenë ambasadorët më të mirë në sport, për ta përfaqësuar Kosovën, në gara ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh që në planifikimin buxhetor së bashku me Ministrin z.Kujtim Gashi, kemi planifikuar që në komunën e Fushë Kosovës, kryesisht në lagjet e

banuara me komunitete Rom, Ashkalinjë dhe Egjiptian, ta ndërtojmë një fushë sportive, ku të rinjtë e këtyre komuniteteve ta shfrytëzojnë për aktivitete sportive, dhe si e tillë kemi arritur që këtë buxhet ta ndajmë nga buxheti i MKRS-së, në këtë mënyrë kam zhvilluar një takim me kryetarin e komunës së Fushë Kosovës, z.Burim Berisha, që ta ndaj një parcelë, për ndërtimin e kësaj fushe. z.Berisha shprehu përkrahje ku në vazhdim do të mundohet ta gjej zgjidhjen për sigurimin tokës për ndertimin e fushës sportive, në Fushë Kosovë.

Aktiviteti radhes ka gene me Ministrin e Zhvillimit Rajonal z.Rasim Demiri, dhe siç dihet që zhvillimi i komuniteteve në biznes është më se i nevojshëm, atëherë me ministrin Demiri, diskutuam për përkrahje të komunitetit Ashkalinjë në biznese, dhe punsim. z.Rasim Demiri, ishte i gatshëm që të bashkëpunoj dhe përkrah komunitetin Ashkalinjë, duke pasur parasysh gjendjen e tyre ekonomike. Në këtë mënyrë vazhdojmë të kemi bashkëpunim me Ministrin Demiri, që bashkarisht t'i zhvillojmë bizneset e Ashkalinjëve si dhe të hapim biznese të reja, në bazë të programeve dhe projekteve që ka ky dikaster.

Kur bëhet fjalë për komunitetet Rom, Ashkalinje dhe Egjiptian, ne e dijmë që është kategoria më e dobët në shoqërinë tonë, pothuajse në të gjitha fushat, pjesë e agjendës time të punëve kisha edhe takimin zëvendësministrin për komunitete dhe kthim, z.Naser Meta, ku diskutuam për sfidat dhe vështërsit që përjetojnë komunitetet, respektivisht të kthyerit nga vendet e ndryshme, u dakorduam që bashkarisht të marrim hapa për t'i ndihmuar ata në procesin e kthimit.

Gjithashtu diskutuam për aktivitetet rinore, ku të rinjtë e komuniteteve, duhet të përfshihen më shumë në aktivitete të ndryshme, pasi që për të kthyerit është shumë e vështirë për tu bërë pjesë e barabartë në shoqërinë Kosovare.

Në javën e parë të muajit Prill, kam takuar zyrtarët policor, nga komuna e Fushë Kosovës, ku kemi diskutuar rreth gjendjes aktuale, dhe kujdesjes më të madhe ndaj dukurive negative që po ndodhin nëpër lagjet e komunitetit Ashkalinjë në këtë komunë. Policia e Kosovës, është e gatshme ta kryjë detyrën e saj siç duhet, në mënyrë që të ketë siguri dhe parandalim të veprimeve të këqija.

## **ii. Organizata Jo Qeveritare**

Në aktivitetin e radhës kam takuar zyrtar nga organizata “World Vision”, të cilët janë duke implementuar projekte të ndryshme në Kosovë, ndër to edhe projektin e radhës, për rini ku kemi diskutuar për mundësinë e lidhjes së një marrëveshje bashkëpunimi, në mënyrë që gjatë procesit të implementimit të projektit, të jemi në dispozicion t’i ndihmojmë dhe përkrahim aktivitetet rinore.

Takimin e radhës me organizatën jo qeveritare “The Ideas Partnership”, e kam realizuar në zyrën time, ku kam pritur zyrtar nga kjo organizatë, e cila merret me aktivitete edukative dhe rinore me të rinjtë e komunitetit Ashkalinje, Rom dhe Egjiptian, nëpër disa komuna të Kosovës. U njoftova me aktivitetet që kjo OJQ është duke zhvilluar, dhe planet e tyre në të ardhmen afatgjate. Gjatë këtij takimi kemi diskutuar rreth bashkëpunimit dhe përkrahjes së TIP-it, në aktivitetet rinore, të cilat janë në të mirë të të rinjëve të komuniteteve, dhe po reflektojnë shumë pozitivisht në zhvillimin e tyre.

## **iii. Klube rinore dhe Sportive**

Aktiviteti i radhës ka qenë një takim me klubin sportiv të futbollit nga radhet e komunitetit Ashkalinjë, kryesishtë me drejtorin e saj z.Gani Emini. Takimi kishte për qëllim bashkëpunimin tonë në mes të klubit dhe MKRS-së, në mënyrë që të përkrahet ky klub, pasi që është klubi i vetëm nga radhet e komunitetit Ashkalinjë, i cili luan për ligën e dytë në nivel të Kosovës. U dakorduam që në vazhdimsi të kemi bashkëpunim në mënyrë që ky klub të mbeshtetet nga MKRS-ja, në mënyrë që të zhvilloj aktivitetet e veta drejë arritjes dhe avansimit të sportit në Kosovë.

Të rinjtë e komunitetit Ashkalinjë, kanë talente të ndryshme, duke përfshirë edhe sportin, ku gjatë kesaj periudhe, kam pritur dy sportist të karates, të cilët janë në përgaditje për garën e radhës ndërkombëtare në Rusi, ku do ta përfaqësojnë Kosovën në sportin e karates. Unë ju urova suksese dhe u shpreha i gatshëm që t’i ndihmoj. Për mua është shumë e rëndësishme që komuniteti Ashkalinjë të arrijë suksese në fushën e sportit, duke përfaqësuar Kosovën dinjitetshëm si qytetar të këtij vendi.

### **III. VIZITA TË NDRYSHME**

Gjatë kësaj kohe, nëpërmes vizitave të ndryshme, jemi munduar që të qëndrojmë sa më afër qytetarëve tanë, duke qenë të informuar rreth problemeve, sfidave dhe sukseseve që përjetojnë klubet sportive, e rinore, organizatat e ndryshme, dhe të rinjtë në përgjithsi. Vizitat tona, kanë reflektuar pozitivisht, duke i parë aktivitetet e drejtëpërdrejta, njëherit përkrahjes së tyre, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, zhvillimit dhe avansimit drejtë sukseseve, në mënyrë që të rinjtë tanë të zhvillojnë aktivitete dhe talentet e tyre, që për Kosovën janë pasuri e padiskutushme.

Gjatë kësaj kohe kemi realizuar 17 vizita, nëpër organizata të ndryshme, klube sportive, klube rinore, dhe grupe të ndryshme të rinjesh. Jemi munduar që gati secilën prej tyre ta ndihmojmë në forma të ndryshme, për t'i arritur qëllimet e tyre pozitive, dhe vazhdojmë të krijojmë mundësi dhe hapsira sa më të mira për ta.

### **DEBATE PUBLIKE**

Është shumë e nevojshme kur dëgjohet zëri i drejtëpërdrejtë i qytetarëve tanë, respektivisht të rinjëve të cilët janë pjesa më e rëndësishme e vendi tonë. Gjatë kësaj periudhe jemi munduar që të jemi sa më shumë afër të rinjëve tanë, në mënyrë që t'i shohim dhe dëgjojmë nga afër problemet, sfidat njëherit tu shprehim mundësit tona për përkrahje dhe bashkëpunim, në këtë mënyrë do të kemi arritje dhe suksese në fusha të ndryshme të jetës.

Kam marrë pjesë në shumë debate publike, ku diskutonim për gjëra të ndryshme, gjë që na jep mundësi të krijojmë ide, dhe plane më afatgjate për qytetarët tanë, duke krijuar strategji më të mirë të punës për sfidat dhe problemet e tyre.

## **IV. ORGANIZIME**

### **i. Aktivitete kulturore e Sportive**

Për nderë të festës së flamurit kombëtar të Ashkalinjëve, kemi organizuar një turnir futbollit, për të rinjtë e komunitetit Ashkalinjë, ku kanë marrë pjesë nga e gjithë Kosova, dhe si e tillë jemi munduar që nëpërmes aktiviteteve sportive, ta shënojmë edhe javën e Ashkalinjëve.

Në javën e flamurit të Ashkalinjëve, kemi organizuar aktivitete kulturore, ku gjatë gjithë javës kemi pasur aktivitete të ndryshme, për ta kremtuar ditën e flamurit të Ashkalinjëve, si dhe ditën e Pavarsisë të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu për nderë të këtyre dy festave shtetërore e kombëtare, kam qene i ftuar në organizimin e ditës kulturore të Ashkalinjëve, dhe përvjetorit të Pavarsisë së Kosovës, në Gjermani, ku ka pasur program kulturo-artistik, të përformuara nga të rinjtë e komunitetit Ashkalinjë në Diaspor. Gjatë kësaj kohe kemi bërë vizita të ndryshme të organizatave që veprojnë në Diaspor, të cilat merren me aktivitete kulturore e humanitare, ku kemi diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit.

## **V. MEDIA**

### **i. Intervista televizive dhe të shkruara**

Siç e dijmë që mediat janë mjet i fuqishëm për promovimin e aktiviteteve pasqyrimin e gjendjes dhe aktiviteteve tona, atëherë kam përdorur si mundësi që të jem pjesë e disa televizioneve, radio dhe portaleve të shkruara, duke pasqyruar gjendjen e komunitetit Ashkali në Kosovë, në fusha të ndryshme, gjegjësisht përfshirjen e tyre në aktivitete kulturore e sportive. Çdoherë duke motivuar të rinjtë tanë që të merren me aktivitete, në mënyrë që ata të zhvillohen me sukses, drejtë së ardhmës së tyre.



# FOTOGRAFI TE AKTIVITETEVE

